








Personeli i 'Kind en Gezin' është këtu për t'ju ndihmuar ju dhe fëmijën tuaj. Ju mund të merrni ndihmë nga ne derisa fëmija juaj të ketë mbushur 3 vjeç. Shërbimet tona janë falas.

Zyrat e konsultimit

Ka disa zyra konsultimi në çdo rajon. Ju do të merrni një takim për një konsultim në çdo hap të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës tuaj. Konsultimet organizohen në bashkëpunim me një organizatë vendore në kohën kur fëmija juaj mbush moshën:

- 4 javë 
- 8 javë 
- 12 javë 
- 16 javë 
- 6 muaj
- 9 muaj 
- 12 muaj 
- 15 muaj 
- 24 muaj
- 30 muaj

Gjatë konsultimit, fëmija juaj do të matet dhe peshohet nga një vullnetare, e pas kësaj ju do të keni mundësinë të flisni me infermierën rajonale rreth ushqimit, zhvillimit, arsimit, etj. Mjeku ose infermierja rajonale monitorojnë rritjen, shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës tuaj dhe i bëjnë vaksinat. Në disa bashki, infermierja rajonale mund të ndihmohet nga një mbështetëse e familjes.

Ne ofrojmë mbështetje të përshtatur për secilën familje. Ne i dëgjojmë pyetjet tuaja dhe përpiqemi t'ju ndihmojmë me informacion, këshilla praktike dhe mbështetje.

Ne do t'ju dërgojmë një email për kujtesë përpara secilit kontakt, për dy kontaktet e fundit do t'ju dërgohen edhe mesazhe SMS.

A keni pyetje të tjera, doni të caktoni një takim apo doni më shumë informacion?

Ju lutemi kontaktoni linjën telefonike 'Kind en Gezin'.

Mund të na dërgoni email nëpërmjet pjesës së kontaktit në faqen tonë të internetit.

Mund të telefononi linjën telefonike të 'Kind en Gezin' për një takim të ri në rast se nuk mund të paraqiteni në takim ose kur fëmija juaj është sëmure.

Linja 'Kind en Gezin': 078 150 100

Mund të telefononi çdo ditë të javës nga ora 8:00 e paradites deri 8:00 e mbrëmjes.

Do të gjeni shumë informacione, broshura, video dhe adresa të dobishme në **www.kindengezin.be**.

Kind en Gezin
Hallepoortlaan 27
1060 BRUSSEL